



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport i Auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK

Mbi zbatimin e procedurave ligjore, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në lidhje me ligjshmërinë e procedurave të ndjekura, në Lidhje me HEC Traja 1, në përroin e zallit dhe HEC Madhesh në lumin e Lunresë, degë e lumit Mat, Bashkia Mat, Qarku Dibër.

Maj, 2021



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport i Auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE		
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....	3
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3 -5
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	5 - 6
II. HYRJA		
1	Objektivat	6
2	qëllimi	6
3	Identifikimi i çështjes	6
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7
5	Përgjegjësitë e audituesve	7
6	Kriteret e vlerësimit	7
7	Standardet e auditimit	8
8	Metodat e auditimit	8
9	Dokumentimi i auditimit	9
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT		
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	9
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit:	9
2.1	HEC ëMadheshë.	9 -11
2.2	HEC ëTraja lë	11 - 20
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET		
		20 -25



I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Projekti i Hartuar për HEC Madhesh dhe Hec Traja nuk ka parashikuar vaditje për zonën, por vetëm prurje ekologjike. Konstatohet se, Institucionet përgjegjëse deklarojnë se nuk ka pasur kërkesa për vaditje, ndërkohë me shkresën drejtuar Njësisë Administrative Ulëz nr. 31/1 prot., datë 01.02.2017, paraqiten nevojat e vazhdueshme për vaditje dhe me shkresën nr. 481/1 prot., datë 09.07.2020 është njoftuar edhe prefektura e Qarkut Lezhë. Nuk rezulton të ketë asnjë publikim për dëgjuesin publike në HEC Madhesh dhe HEC Traja, në kundërshtim me VKM nr. 247 datë. 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informim dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore", kreu 1 pika 1. Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe konsultimit me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, konstatohet se, arsyeja pse Baseni Ujor shprehet se nuk ka kërkesë për vaditje në atë zonë, është se kërkesat e vazhdueshme nga banorët nuk janë bërë sipas procedurave të parashikuara.

I.2 Një përshkrim i përmblendhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi,

Gjetja nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në Rap.Përf.	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi i dosjes fizike në MIE, rezultoi se, Baseni Ujor Mat ka miratuar: (i) lejen e përdorimit të ujit me nr. serie 000029, të datës 22.09.2017, të miratuar me Vendimin e KBU nr. 31, datë 22.09.2017; dhe (ii) lejen për përdorimin e burimit, miratuar me Vendimin e KBU Mat, Nr. 132 datë 22.09.2017. Nga miratimi i lejes së përdorimit të ujit, është vendosur kufizimi në ushtrimin e veprimtarisë duke përcaktuar që <u>të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezervat e domosdoshme ekologjike.</u> Në vijim të sa me sipër, nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se <u>projekti i hartuar për HEC Madhesh dhe Hec Traja nuk kanë parashikuar vaditje për zonën,</u> por vetëm prurje ekologjike. Referuar dokumentacionit të administruar në MIE mbi VNM-në e vitit 2020, hartuar nga shoqëria projektuese "D ó alb" sh.p.k, citohet se "Për Hec Madhesh, prurja	9- 20	E lartë	Me qëllim forcimin e kontrolleve të brendshme, në funksion të efikasitetit dhe ligjshmërisë së procesit si dhe në mbështetje të kuadrit ligjor e rregullator në fuqi për menaxhimin e integruar të Burimeve Ujore: - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të ngrëjë një grup pune të veçantë, për të verifikuar çështjet e trajtuara, me qëllim rishikimin e kontratës koncesionare, duke qenë se nevojat e vazhdueshme për vaditje të banorëve nuk janë marrë në konsideratë dhe si pasojë nuk janë llogaritur dhe vlerësuar në projektin e zbatimit të HECE-ve. - Grupi i punës të bashkëpunojë me Institucionet e tjera përgjegjëse të përfshira në këtë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport i Auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

	<p>ekologjike për veprën e marrjes nr. 1 është 0.023 m³/sek, ndërsa për veprën e marrjes nr. 2 është 0.003 m³/sek. <i>Ujë që do të lihet për vaditje nuk ka, sepse nuk ka kërkesa për vaditje në këtë zonë.</i> Prurja llogaritëse për veprën e marrjes nr 1 është 0.11 m³/s ndërsa për veprën e marrjes nr 2 është 0.99 m³/s. Nga verifikimi i projektit rezultoi se, llogaritjet energjetike të Hec-it janë llogaritur të plota me Prurjen, <u>duke mos lejuar hapësirë nga burimi për vaditje.</u> Konstatohet se, Institucionet përgjegjëse deklarojnë se nuk ka pasur kërkesa për vaditje, ndërkohë me shkresën drejtuar Njësisë Administrative Ulëz nr. 31/1 prot., datë 01.02.2017, paraqiten nevojat për vaditje dhe me shkresën nr. 481/1 prot., datë 09.07.2020 është njoftuar edhe prefektura e Qarkut Lezhë.</p> <p>Sa më sipër, sipas Ligji Nr. 111/2012 <i>oPër Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore</i> parashikohet një hapësirë ku Këshilli i Basenit Ujor pezullon përkohësisht ose ndryshon lejen ose autorizimin, nëse rrethanat, në të cilat është bazuar dhënia e tyre, kanë ndryshuar, ose kur krijohen rrethana të reja, të cilat nëse do të kishin ekzistuar në kohën e dhënies së lejes do të kishin çuar në lëshimin e lejes me kushte të tjera. Thënë kështu, edhe nëse nuk ka patur kërkesa për vaditje përpara se të jepej leja e përdorimit të ujit, siç pretendohet nga Baseni Ujor Mat, kërkesat e kryera në vijimësi nga banorët e zonës janë të mjaftueshme për të rishikuar kushtet e lejes.</p>			<p>projekt, me qëllim analizimin dhe vlerësimin e të gjithë elementet të projektit, si: Vlerësimin të Ndikimit në Mjedis, Oponencën teknike dhe Lejet e Përdorimit të Ujit, në mënyrë që të rishikohen dhe ri studiohen llogaritjet hidrologjike, për nevojat dhe sasinë e ujit për vaditje Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, me qëllim verifikimin e ligjshmërisë së procesit për çështjen në fjalë si dhe për marrjen e masave që për çdo rast në vijim, përpara dhënies të lejeve të përdorimit të ujit, të verifikojë të gjitha kërkesat dhe nevojat e burimit ujqor, me qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë së prioriteteve mbi përdorimin ujqor. Në fund të këtij verifikimi, të bëhet me dije KLSH, mbi rezultatet e punës.</p>
2	Referuar publikimeve zyrtare në AKM (Agjencinë Kombëtare të Mjedisit), konstatohet se nga verifikimi në faqen zyrtare të AKM në Prill 2020, nuk	9- 20	E lartë	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim forcimin e kontrolleve të brendshme, për të garantuar një proces sa më



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

Raport i Auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

<p>rezulton të ketë asnjë publikim për dëgjesën publike në HEC Madhesh dhe HEC Traja1, në kundërshtim me VKM nr. 247 datë. 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informim dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore", kreu 1 pika 1.</p> <p>Procesi i informimit dhe i përfshirjes së publikut gjatë procedurës paraprake të Vendimit mbi Ndikimin Mjedisor (VNM) përfshin informimin dhe marrjen e mendimit të publikut nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) për projektin, shoqëruar me sqarimet për procedurën në zbatim, <u>si dhe shpalljen dhe publikimin e vendimit të AKM-së në faqen e saj të internetit</u>, si një hap me rëndësi për të garantuar transparencë në proces. Në kushtet kur ka një pretendim të ngritur nga banorët në lidhje me cenimin e këtij procesi, vlerësojmë që dëgjesa publike duhet të ishin përditësuar dhe publikuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>			<p>transparent, në çdo rast të marrë masa që të verifikojë kryerjen e dëgjesave publike, sipas kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p>-Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet strukturave përkatëse, të ushtrojë kontrollin e nevojshëm mbi ligjshmërinë e kryerjes së procedurave të dëgjesës publike nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për rastin në fjalë, dhe në përfundim të këtij kontrolli, të bëhet me dije Kontrolli i Lartë i Shtetit mbi rezultatet e punës së kryer.</p> <p>- Agjencia Kombëtare të Mjedisit me qëllim marrjen e masave që për çdo rast në vijim, të kryejë dëgjesën publike, sipas parashikimeve në VKM nr. 247 datë. 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informim dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore", si një kusht i rëndësishëm për garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis.</p>
---	--	--	--

I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Projekti i Hartuar për HEC Madhesh dhe Hec Traja nuk ka parashikuar vadijtje për zonën, por vetëm prurje ekologjike. Referuar dokumentacionit të administruar në MIE mbi VNM e vitit 2020 hartuar nga shoqëria projektuese "Dekliada ó alb" sh.p.k, citohet se "Për Hec Madhesh, prurja ekologjike për veprën e marrjes nr. 1 është 0.023 m³/sek, ndërsa për veprën e marrjes nr. 2 është 0.003 m³/sek. **Ujë që do të lihet për vadijtje nuk ka, sepse nuk ka kërkesa për vadijtje në këtë zonë.** Prurja llogaritëse për veprën e marrjes nr 1 është 0.11 m³/s ndërsa për veprën e marrjes nr 2 është 0.99 m³/s. Nga verifikimi i projektit rezultoi se llogaritjet energjetike të Hec-it janë llogaritur të plota me Prurjen, duke mos lejuar hapësirë nga burimi për vadijtje. **Konstatohet se, Institucionet përgjegjëse deklarojnë se nuk ka pasur kërkesa për vadijtje,**



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport i Auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

ndërkohë me shkresën nr. 31/1 prot., datë 01.02.2017, drejtuar Njesisë Administrative Ulëz, paraqiten nevojat e vazhdueshme për vaditje dhe me shkresën nr. 481/1 prot., datë 09.07.2020 është njoftuar edhe prefektura e Qarkut Lezhë.

Referuar publikimeve zyrtare në AKM (Agjencinë Kombëtare të Mjedisit), konstatohet se nga verifikimi në faqen zyrtare të AKM në Prill 2020, **nuk rezulton të ketë asnjë publikim për dëgjuesën publike** në HEC Madhesh dhe HEC Traja1, në kundërshtim me VKM nr. 247 datë. 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informim dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore", kreu 1 pika 1. Procesi i informimit dhe i përfshirjes së publikut gjatë procedurës paraprake të VNM-së përfshin informimin dhe marrjen e mendimit të publikut nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) për projektin, shoqëruar me sqarimet për procedurën në zbatim, si dhe shpalljen dhe publikimin e vendimit të AKM-së në faqen e saj të internetit. Nuk është garantuar transparencë në procesin e VNM.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe konsultimit me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, konstatohet se, arsyeja pse Baseni Ujor shprehet se nuk ka kërkesë për vaditje në atë zonë, është se kërkesat e vazhdueshme nga banorët nuk janë bërë sipas procedurave të parashikuara.

Banorët pretendojnë se, kërkesat e tyre të para fillojnë që në vitin 2001, në rrugë jozyrtare nëpërmjet kryeplakut të fshatit drejtuar njesisë administrative përkatëse, dhe vijnë deri ditët e sotme. Në vitin 2017, me anë të shkresës nr. 31/1 prot., datë 01.02.2017, drejtuar Njesisë Administrative Ulëz, banorët kanë paraqitur kërkesën për vaditje, kësaj rradhe në rrugë zyrtare. Për këto arsye dhe sa trajtuar në këtë raport japim opinion të kundërt të përputhshmërisë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSHö, në zbatim të autorizimit nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1146/3, datë 17.12.2020, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, nga data 17.12.2020 deri në datën 08.01.2021, për verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura, në lidhje me HEC Traja 1 dhe HEC Madhesh, u krye auditimi në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, i iniciuar nga shkresa e ardhur në KLSH me dt. 13.11.2020, protokolluar me tonën me nr.1146 Prot, dt.13.11.2020, ankesë e disa banorëve të fshatit Madhesh, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A. K., përgjegjës grupi;
2. D. P., anëtar;
3. A. V., anëtar.

Objekti i auditimit:

Objekti i këtij auditimi është auditimi i ligjshmërisë së procedurave të ndjekura, në lidhje me HEC Traja 1 dhe HEC Madhesh

Qëllimi i auditimit është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Qëllimi i auditimit është të identifikojë dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport i Auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj.

Çështja të cilat do të trajtohen në këtë projekt, lidhet me auditimin mbi vlerësimin e miratimit të lejeve dhe miratimeve për përdorimin e Ujit.

Identifikimi i çështjes:

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi i ligjshmërisë për miratimet e procedurave të ndjekura për autorizimet e ndërtimit të HEC Traja 1 dhe HEC Madhesh, janë parashikuar sipas drejtimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në autorizimin për kryerjen e auditimit tematik Nr.prot.,1146/3, datë 17.12.2020.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Ministria e Infrastrukturës është përgjegjëse e linjës dhe institucionet përkatëse të varësisë shqyrtojnë përputhshmërinë me politikat, strategjitë e legjislacionin sektorial dhe kushtet teknike të veçanta për objektin përkatës. Staf i menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve natyrore në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e detyrimeve kontraktuale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare e natyrore të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Kriteret e vlerësimit:

- Ligji 43/2015 datë 30.04.2015 òPër sektorin e energjisë elektrikeò, i ndryshuar te VKM nr. 822 datë 07.10.2015 òPër miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioniò, i ndryshuar.

- ligjit nr. 111/2012 òPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreò

- VKM nr. 1080 date 13.12.2013 òPër Krijimin dhe Përberjen e Këshillit Kombëtar të Ujitò

- VKM nr. 230 date 23.4.2014 òPër Përberjen dhe Mënyren e Organizimit dhe të Funkcionimit të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujitò

- VKM nr. 416, datë 13.05.2015 Për Miratimin e Kushteve të Përgjithshme e të Posacme,



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport i Auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

- VKKU nr. 5 date 16.2.2016 ðPër Miratimin e Rregullores ðPër Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Basenit Ujorë
- VKM nr. 342 date 4.5.2016 ðPër Miratimin e Kufijve Territoriale e Hidrografike të Baseneve Ujore në Republikën e Shqipërisë dhe Qëndren e Përberjen e Këshillit të Secilit Prej Tyreë
- VKM nr. 822 datë 07.10.2015 ðPër miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesionië,
- VKM 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit",

Standardet e Auditimit

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ðPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik (ISSAI).

- ISSAI 100 - (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.
- ISSAI 4000 ðStandarti i Auditimit të Përputhshmërisëë
- INTOSAI-P 10ðDeklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e - SAI-të, si dhe INTOSAI-P 30ð Kodi Etikësë.

Metodat e auditimit

Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në metodologjinë e aplikuar gjatë fazës së planifikimit dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga subjekti i audituar. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshme në institucion sa i takon:

(a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontrolleve.

1. *Kontroll aritmetik* që konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin.

1. *Inspektim fizik* dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse.

2. *Kontrolli i vlerësimit* për të përcaktuar nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, në përputhje me vlerat e paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3-*Verifikimi i transaksioneve* duke marrë informacion shtesë nga burime të tjera verifikuese.

4-*Intervistimi i personelit* që ka patur role specifike në subjektin që u auditua.

5-*Raporte dhe informacione* nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit të marra në formë elektronike dhe shkresore.

6-*Pyetësorë* për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.



Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave, evidencat e marra gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale të bëra në arritjen e konkluzioneve u konsideruan të përshtatshme dhe të rëndësishme për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve dhe shërbyen si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, observacioneve të paraqitura nga subjekti mbi akt-konstatimet e lëna në subjekt, dhe takimit përmbyllës mbas fazës së përfundimit në terren midis niveleve drejtuese në datën 20.01.2021, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Auditimi në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, u krye në kuadër të autorizimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura, në lidhje me HEC Traja 1 dhe HEC Madhesh. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën studim-projektimit të HEC-ve, si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me lejet dhe miratimet sipas kuadrit rregullator në fuqi. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

- Objekt i këtij auditimi është rregullshmëria dhe ligjshmëria për procedurat e miratimit të HEC Traja 1 dhe HEC Madhesh.
- Qëllimi i auditimit: Auditimi tematik mbi përputhshmërinë e procedurave administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi. Evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë të natyrës, shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike, si dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes në vijim.



- Fushëveprimi i auditimit: Vlerësimi i procedurave nga Institucionet - shtrirë sipas drejtimit të autorizimit të auditimit. Janë audituar dokumentacionet dhe të dhënat në lidhje me subjektin për periudhën nga inicimi i kërkesave nga subjektet, lejet dhe miratimet e HEC-eve.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

Në zbatim të autorizimit nr. 1146/3, datë 17.12.2020, u shqyrtua dokumentacioni i kontratës për lejet e shfrytëzimit të Hec Madhesh dhe TRAJA 1, dhe u mbajt akt-konstatim më datë 08.01.2021.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e miratimit të dhënies për shfrytëzim për Hec Traja1 dhe Hec Madhesh, konstatohet:

A.1 HEC “Madhesh”

Në zbatim të Ligjit 43/2015 datë 30.04.2015 *“Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, të VKM nr. 822 datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar, më datë 09.02.2017, shoqëria “ARM A.ö shpk ka aplikuar pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për ndërtimin e centraleve elektrike “Madhesh” me kapacitet prodhues 920 kV, në lumin e Lunresë, degë e lumit Mat, Bashkia Mat, Qarku Dibër.*

- “ARM A.ö shpk aplikimin e ka shoqëruar me dokumentacionin sipas nenit 7, të VKM nr. 822 datë 07.10.2015 *“Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar.*

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë pas shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “ARM A.ö shpk ka pajisur shoqërinë, me miratimin paraprak nr. 909/5 prot., date 31.05.2017, për vazhdimin e procedurës për ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë elektrike HEC “Madhesh” me kapacitet prodhues 920 kV, në lumin e Lunresë, degë e lumit Mat, Bashkia Mat, Qarku Dibër me koordinata:

Vepra e marrjes 1 X: 44 06 073 Y: 46 10 945 Z: 193.87 m,

Vepra e marrjes 2 X: 44 05 572 Y: 46 11 053 Z: 200 m,

Godina e centralit X: 44 04 946 Y: 46 13 334 Z: 84 m,

- Shoqëria ARM A.a ka paraqitur në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, dokumentet e mëposhtme:

1. *Vendimin nr. 40 për VNM Paraprake nr. identifikimi 719 për ndërtimin e hidrocentralit Madhesh, lëshuar Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me nr. 2511 prot., date 12.10.2017; nga Agjencia Kombëtare e mjedisit (AKM), drejtorja e Vlerësimit Mjedisor;*

VNM Paraprake nr. 2511 datë 12.10.2017

2. *Miratimin e OSHEE me nr. 19889/4 prot., datë 07.9.2017 për pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, sipas kërkesave të kodit të transmetimit ose shpërndarjes;*

3. *Ofertën për lidhjen e burimit të ri gjenerues me rrjetin shpërndarës nga OSHEE nr. 19889/1 datë 05.09.2017;*

4. *Kontratë qiraje me Kryetar Bashkie z. N. R. për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik nr. 277 datë 01.02.2018, mbi pasurinë që do të përdoret për ndërtimin dhe operimin e*



hidrocentralit. Konstatohet se, në kohën e dhënies së kontratës së qirasë me subjektin "ARM A." nuk ka konflikt interesi me Bashkinë Mat.;

5. Leje për përdorimin e burimit, miratuar me vendim të Këshillit të Basenit Ujor Mat, nr. 132, datë 22.09.2017;

6. Raport oponente teknike për projektin e zbatimit të HEC-it "Madhesh" nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore AKBN nr. 6139/4/6 datë 07.09.2017;

7. Studimin ekonomik dhe financiar të projektit, të shoqëruar me dokumente që vërtetojnë financimin nga vetë aplikuesi, apo/dhe mbështetjen financiare të projektit nga institucionet financiare ose bankat vendase apo të huaja, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit për HEC Madhesh;

8. Studimin gjeologjik;

9. Studimin hidrogeologjik;

10. Preventivin dhe Grafikon e zbatimit të projektit për HEC Madhesh.

MIE ka lidhur kontratën me subjektin "ARM A." sh.p.k. me nr. 1416 Rep., nr. 922/3 kol., datë 27.06.2018 "Për ndërtim, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit "Madhesh".

A.I.2. Grupi i auditimit, nisur nga ankesa e banorëve të fshatit Madhesh, kërkoi informacion zyrtar mbi lejen e përdorimit në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, e cila ka si mision mirëqeverisjen e burimeve ujore me qëllim përmbushjen e të gjitha nevojave jetësore, duke mbajtur në vëmendje qëndrueshmërinë e ekosistemeve, duke nxitur konkurrueshmërinë e përdorimeve dhe prioritarizimit drejt përfitueshmërisë ekonomike, nga ku rezultoi se:

Nga të dhënat e faturimeve që kryhen nga Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Ishëm-Erzen-Mat, subjekti nuk është faturuar për prodhim energjie për HEC Madhesh. Mbështetur në mos faturimin e deritanishëm dhe në faktin se ky HEC nuk rezulton ndër HEC-et që prodhojnë energji sipas raporteve të ERRE për vitet 2018, 2019 dhe 2020, arrihet në konkluzion se HEC Madhesh nuk ka filluar akoma prodhimin e energjisë elektrike. Kjo vërtetohet edhe nga Relacioni i Verifikimit, të kryer në këtë HEC nga AMBU në korrik 2020. Pra, HEC-i është në fazën e ndërtimit. Leja e tij ka një afat 5 vjeçar (**deri më datën 22.09.2022**).

Sipas dokumenteve të aplikimit (formulari i aplikimit dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis) afati i përfundimit të projektit/faza e ndërtimit është deklaruar 48 muaj.

- Në lidhje me ankimimin e banorëve të fshatit madhesh për këtë HEC, pranë AMBU, nëpërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (shkresa nr. 4441 prot., datë 17.06.2020, protokolluar në AMBU me nr. 706 prot., datë 01.07.2020) është disponuar ankesa e banorëve të fshatit Madhesh në lidhje me shqetësimin mbi mundësinë e përdorimit të ujit të fshatit (konkretisht lumi Lunder apo i Lunrese siç është përcaktuar në leje) për prodhim hidroelektroenergjie, gjë që mund të cenojë ujitjen e tokave. Gjithashtu i njëjti shqetësim nëpërmjet të njëjtës ankesë është përcjellë pranë Zyrën e Administrimit të Basenit Ujore Ishëm-Erzen-Mat nga Prefekti i Qarkut Lezhë me nr. 481/1 prot., datë 9.07.2020.

- AMBU, nisur nga kjo ankesë, në bashkëpunim me Zyrën e Administrimit të Basenit Ujor Ishëm-Erzen-Mat, kanë kryer verifikimin në terren dhe kanë marrë kontakt me kryeplakun e fshatit dhe dy banorë. Konkluzionet e verifikimit janë shprehur në Relacionin përkatës të datës



23.07.2020. Ky relacion i është në vënë në dispozicion Prefektit të Qarkut Lezhë nga Zyra e Administrimit të Basenit Ujor (ZABU) me shkresë nr. 268/1 datë 03.09.2020.

Sa më sipër, konstatohet verifikim pjesor nga AMBU, pasi nuk është realizuar dëgjesa e asnjë prej banorëve të ankuar, por janë përfshirë 3 banorë që nuk bëjnë pjesë në ankesën për vaditje.

Hec Madhesh dhe subjekti ðA.R.M.-A.ö, është pajisur me leje për përdorim burimi uJOR për prodhim hidroenergjie, nga Këshilli Basenit Ujor Mat me Nr. Serie 000080, të protokolluar më datën 22.09.2017, e miratuar me Vendimin e nr. 32, datë 22.09.2017. Paraprakisht, është pajisur me autorizim për përdorim burimi uJOR (miratimin në parim) me Nr. Serie 000021, me numër protokolli 31, datë 22.02.2017, të miratuar me Vendimin KBU Mat nr. 22, datë 22.02.2017.

A.2 HEC “Traja 1”

Në zbatim të Ligjit 43/2015 datë 30.04.2015 ðPër sektorin e energjisë elektrikeö, i ndryshuar të VKM nr. 822 datë 07.10.2015 ðPër miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioniö, i ndryshuar, Shoqëria ðARM A.ö shpk me date 09.02.2017 ka aplikuar pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për ndërtimin e centraleve elektrike ðTraja 1ö dhe ðTraja 2ö, në përroin e Zallit të Trajes, degë e përroit Zalli i Terrajcës, degë e lumit Mat, Bashkia Mat, Qarku Dibër nga kuota 370 m (vepra e marrjes) deri në kuotën 230 m (godina e centralit) për HEC Traja 1 dhe nga kuota 226 m (vepra e marrjes) deri në kuotën 142 m (godina e centralit) për HEC Traja Shoqëria ðARM A.ö shpk; aplikimin e ka shoqëruar me dokumentacionin sipas nenit 7 të VKM nr. 822 datë 07.10.2015 ðPër miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioniö, i ndryshuar.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë pas shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë ðARM A.ö shpk ka pajisur shoqërinë, me miratimin paraprak nr. 908/5 prot., date 30.05.2017 ðPër vazhdimin e procedure për ndërtimin e burimit të regjenerues të energjisë elektrike HEC Traja 1, në përroin e Zallit të Trajes, degë e përroit të Terrajcës, lumi Mat nga kuota 370m (vepra e marrjes) deri në kuotën 230 m (godina e centralit)ö. Pra, duke miratuar kështu vetëm njërin nga hidrocentralët, atë ðTraja 1ö. Me qëllim marrjen e miratimit përfundimtar për HEC Traja 1, shoqëria ARM A. ka paraqitur në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, dokumentet e mëposhtme:

1. Studimin e plotë të fizibilitetit teknik, mjedisor e social, si dhe projektin e zbatimit, të bazuar në të dhëna dhe matje reale të kryera në zonat e zbatimit të projektit për ndërtimin e hidrocentralit Traja;
2. Studimin e plotë ekonomik dhe financiar të projektit, të shoqëruar me dokumente që vërtetojnë financimin nga vetë aplikuesi, apo/dhe mbështetjen financiare të projektit nga institucionet financiare ose bankat vendase apo të huaja, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe strukturën e financimit për HEC Traja 1;
3. Grafikonin e zbatimit të projektit për HEC Traja 1;
4. Miratimin e OSHEE me nr. 19889/3 prot., datë 7.9.2017 për pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, sipas kërkesave të kodit të transmetimit ose shpërndarjes;
5. Vendimin nr. 37 për VNM Paraprake nr. identifikimi 680 për ndërtimin e hidrocentralit Traja 1, lëshuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me nr. 2363 prot., datë 19.9.2017;
6. Studimi gjeologjik;
7. Studimi hidrogjeologjik;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport i Auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

8. Raportin e Oponencës Teknike të AKBN nr. 6140/4 prot., datë 7.9.2017 mbi projektin e zbatimit për ndërtimin e hidrocentralit Traja 1;

9. Leje për përdorim të burimit ujqor nr. 131 prot., datë 22.9.2017, miratuar me vendim të këshillit të Basenit Ujqor Mat nr. 31 datë 22.9.2017 për hidrocentralin Traja 1;

10. Kontratën e qirasë për dhënien në përdorim të fondit pyjqor/kullosor publik nënshkruar me Bashkinë Mat me Kryetar Bashkie N. R. me nr. 278 prot., datë 1.2.2018, që provon marrëdhënien mbi pasurinë që do të përdoret për ndërtimin dhe operimin e hidrocentralit Traja 1. Konstatohet se në kohën e dhënies së kontratës së qirasë me subjektin "ARM A." nuk ka konflikt interesi me Bashkinë Mat.

A2.2. Grupi i auditimit, nisur nga ankesa e banorëve të fshatit Madhesh për Hec "Traja 1", kërkoi informacion zyrtar mbi lejen e përdorimit në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujqore, nga ku rezultoi se:

- Hec Traja (HEC Traja 1) dhe subjekt òA.R.M.- A.ò, është pajisur me leje për përdorim burimi ujqor për prodhim hidroenergjie, nga Këshilli Basenit Ujqor Mat me Nr. Serie 000079, të protokolluar më datën 22.09.2017, e miratuar me Vendimin e nr. 31, datë 22.09.2017. Paraprakisht, është pajisur me autorizim për përdorim burimi ujqor (miratimin në parim) me Nr. Serie 000022, me numër protokolli 31, datë 22.02.2017, të miratuar me Vendimin KBU Mat nr. 123, datë 22.02.2017,

Dispozitat në fuqi për trajtimin dhe miratimin.

Miratimi në Parim dhe miratimi i Lejes së Përdorimit të burimit ujqor, mbështetet dhe i referohet:

- Pikës 2 të nenit 7, pika 2 e nenit 50, neni 51 dhe 52 i ligjit nr. 111/2012 òPër menaxhimin e integruar të burimeve ujqoreò, në fuqi në momentin e dhënies së miratimit në fjalë.
- VKM nr. 416, datë 13.05.2015;
- Germa òcò e nenit 24 të VKM nr.822, datë 7.10.2015;
- Miratimit paraprak i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë me Nr.908/5, datë 30.05.2017.
- Procedura që ndiqej nga Agjencia e Basenit Ujqor (Mat), përpos legjislacionit të mësipërm, bazohej në òRregulloren për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujqorò, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Ujqit nr.6, datë 16.02.2016. Ndërsa procedura që ndiqej nga Këshilli i Basenit bazohej në òRregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujqorò, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Ujqit nr.5, datë 16.02.2016
- Gjithçka inicohet nga kërkesa e subjektit të interesuar pranë Agjencisë së Basenit Ujqor (Mat në rastin konkret), e shoqëruar me pagesën e tarifës së aplikimit dhe dokumentacionin përkatës, të përcaktuar në VKM nr. 416, datë 13.05.2015 òPër Miratimin e Kushteve të Përgjithshme e të Posacmeò.

AMBU shqyrton përputhshmërinë e dokumentacionit me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm dhe, në rast se ato përmbushen, harton relacionin përkatës dhe, së bashku me dokumentacionin e aplikimit, ia paraqet anëtarëve të Këshillit të Basenit Ujqor, 7 ditë përpara datës së mbledhjes së caktuar nga Kryetari i Këshillit të Basenit. Aplikimet dërgoheshin për vlerësim paraprakisht në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e cila paraqiste, përpara datës së mbledhjes, opinionin e saj në lidhje me çdo çështje të parashikuar për t'u trajtuar në mbledhjen e KBU, pranë përgjegjësit të Agjencisë së Basenit Ujqor përkatës dhe Kryetarit të Këshillit të Basenit.



Kërkesat, dokumentet dhe relacionet përkatëse trajtoheshin në mbledhjen e KBU, në të cilën, me votim, miratohej ose jo kërkesa e subjekteve. Të gjitha këto procedura, tani kryhen online.

Prioriteti sipas llojit të përdorimit përcakton:

Mbështetur në përcaktimet e nenit 52 të ligjit nr.111/2012 *“Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore*”, në fuqi në momentin e dhënies së lejes në fjalë (por edhe në ligjin e ndryshuar në vitin 2018), për dhënien e një lejeje, autorizimi, koncesioni, organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore përkatëse të ujit mbështeten në përparësitë e mëposhtme:

- a) furnizimin me ujë të popullsisë, përfshirë edhe kërkesat e industrive që ndodhen brenda vijës kufizuese të qendrave të banuara dhe që kanë një nivel të ulët konsumi;
 - b) *përdorimet për ujitje, bujqësi e akuakulturë;*
 - c) *përdorime për prodhim energjie elektrike nëpërmjet burimeve hidrike;*
 - ç) përdorime të tjera industriale, që nuk përfshihen në kategorinë e mësipërme, përfshirë edhe përdorime në miniera;
- etj.

Në kuptim të këtyre përcaktimeve, edhe të faktit se dhënia e lejeve/ autorizimeve/konkencioneve, iniciohet nga kërkesa për pajisje me leje/autorizim nga subjekti që do të përdorë burimin ujor, procesi i prioritarizimit në dhënien e burimit në përdorim, administrohet nëpërmjet mekanizmave të tjerë që janë: (1) kushteve teknike të vendosura në leje (si p.sh. detyrimi për masën e rrjedhës ekologjike që duhet garantuar nga përdoruesi), dhe (2) nga autoriteti që kanë anëtarët përfaqësues të institucioneve pjesëmarrëse në vendimmarrjet e Këshillit të Basenit Ujor (përfaqësues të të gjithë bashkive që i përkasin territorit të basenit ujor, të shoqërive të ujësjetllës kanalizimeve, të bordeve/drejtorive të ujitjes dhe kullimit, të agjencive rajonale të mjedisit, të shëndetit publik dhe grupe të interesit), të cilët disponojnë informacionin dhe kanë autoritetin për të prezantuar dhe mbrojtur këtë prioritarizim. Referuar vendimmarrjes së Këshillit të Basenit Ujor, konstatohet se nuk është konsideruar si prioritare nevoja për vaditje e banorëve, ndaj përdorimit të ujit për hidroenergji.

Funksioni i vendimmarrjes dhe mendimi i institucioneve përgjegjëse për ujitjen.

Në bazë të Ligjit Nr. 24/2017 *“Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit*”, drejtoritë e ujitjes dhe kullimit dhe 61 bashkitë janë përgjegjëse për operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin e infrastrukturës së ujit, kullimit, mbrojtjes nga përmbytjes dhe sigurimin e digave (ndër të tjera) me qëllim të plotësojë nevojat për ujë për ujitje.

Në kuptim të sa më lart, përfaqësuesit e institucioneve të lartpërmendura, në ushtrimin e funksionit të anëtarit të KBU, në zbatim edhe të përcaktimeve të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 5, datë 16.02.2016 *“Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimit e Këshillit të Basenit Ujor*”, (në fuqi në kohen kur është kjo vendimmarrje), duhet të japin mendim në lidhje me propozimet për miratimet në parim dhe miratimet për leje përdorimi. (në lidhje me propozimet dhe dokumentet shoqëruese të aplikimit anëtarët njihen të paktën 7 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes).

- Në lidhje me aplikimet për pajisje me leje, si dhe me territorin në të cilën ndodhet HEC Traja dhe HEC Madhesh, rezulton se Bashkia Mat, me shkresën Nr. 812/2, datë 1.10.2019, ka



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport i Auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

informuar AMBU në lidhje me burimet ujore që përdoren për ujë të pijshëm dhe vaditje. Mbështetur në këtë informacion deklarohet se Përroi i Trajës dhe lumi i Lunresë, është një burim që përdoret për hidroenergji dhe vaditje njëkohësisht. Nga ana tjetër, mbështetur në regjistrat e përdoruesve të burimeve ujore rezulton se nuk ka leje/autorizim për përdorim të këtij burimit ujor për vaditje (Bashkia deklaron se është me leje, por i referohet lejes për përdorim për hidroenergji).

Ankesa e banorëve të fshatit Madhesh, u është drejtuar shumë Institucioneve Shtetërore në rrugë zyrtare, për kërkesat e vazhdueshme për vaditje si më poshtë:

1. Shkresë drejtuar Njesisë Administrative Ulëz nr. 31/1 prot., datë 01.02.2017;
2. Dërguar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 4701 dëftesë 15.06.2020;
3. Dërguar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit, Drejtorisë së Politikës Ujore nr. 4701 dëftesë 15.06.2020;
4. Dërguar Njesisë Administrative Ulëz nr. 4701 dëftesë 15.06.2020;
5. Dërguar Bashkisë Mat nr. 4701 dëftesë 15.06.2020;
6. Dërguar Njesisë Administrative Ulëz nr. 1030 dëftesë 23.12.2020;
7. Dërguar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 1030 dëftesë 23.12.2020;
8. Dërguar Kryeministrisë nr. 1030 dëftesë 23.12.2020;
9. Dërguar Basenit Ujor Mat nr. 4701 dëftesë 15.06.2020;
10. Dërguar Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura nr. 4701 dëftesë 15.06.2020;
11. Dërguar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nr. 4701 dëftesë 15.06.2020.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u është kthyer përgjigje, si më poshtë:

1. Kthim përgjigje nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura me shkresë nr. 604/1 prot., datë 13.07.2020, ku konstaton se, bazuar koordinatave të projektit Godina e Hec-it, ndodhet 130 m larg Parkut Natyror Bashkia Ulëz dhe strukturat e tjera të Hec-it ndodhen jashtë sistemit të zonave të mbrojtura.

Nga verifikimi i grupit të auditimit të koordinatave të Hec-ve në Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), rezulton se Hec-et janë jashtë zonës së mbrojtur të Parkut Natyror Ulëz.

2. Kthim përgjigje nga AKM me nr. 2074/1 prot., datë 06.07.2020, ku citon vetëm mbështetjet e vendimit për vendimin e VNM paraprake dhe nuk jep zgjidhje mbi kërkesat apo rigjykim mbi VNM të miratuar prej këtij Institucioni.

3. Kthim përgjigje nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit nr. 1150/01 prot., datë 12.11.2020, ku i drejton banorët pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, e cila ka për kompetencë shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave që lidhen me çështjet e zhvillimit të territorit.

Për çështjet e miratimit të lejeve, banorët e fshatit Madhesh kanë realizuar Kallëzim Penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë me Nr. 5933/4 datë 17.12.2020, kundër shtetasve Fatos Malaj, administrator i "ARM A.a shpk", Agim Hasanlami ekspert mjedisi dhe Xhabir Xhediku specialist i Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Dibër, për veprën penale "falsifikim i dokumenteve" dhe "shpërdorim i detyrës" me subjekte të AKM.

Në kallëzim pretendohet se, në dëgjesën publike ka persona të cilët nuk janë banorë të fshatit dhe se AKM, në kushtet e pandemisë Covid-19, ka realizuar konsultimin më datë 08.04.2020.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport i Auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Gjithashtu, pretendohet se VNM përmban të dhëna të rreme, pasi deklarohet se nuk ka kërkesa për vaditje.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, grupi i auditimit sa më sipër konstaton:

1. Baseni Ujor Mat ka miratuar leje të përdorimit të ujit me nr. serie 000029, të datës 22.09.2017, të miratuar me Vendimin e KBU **nr. 31, datë 22.09.2017**. Sipas lejes për përdorimin e burimit, miratuar me vendim të Këshillit të Basenit Ujor Mat **Nr. 132 datë 22.09.2017**, është vendosur kufizimi në ushtrimin e veprimtarisë, konkretisht: ***Të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezervat e domosdoshme ekologjike.***

Pra, sa më sipër, ky është një nga kushtet e lejes, i cili në rast se vërtetohet dhe dokumentohet se nuk plotësohet, siç konstatohet më sipër, përmbush përcaktimet e nenit 50, 55 dhe 80 të ligjit nr.111/2012 i ndryshuar nga ku MIE duhet të rishikojë kushtet e kontratës të HEC-it.

2. Projekti i Hartuar për HEC Madhesh dhe Hec Traja nuk ka parashikuar vaditje për zonën, por vetëm prurje ekologjike. Referuar dokumentacionit të administruar në MIE mbi VNM e vitit 2020 hartuar nga shoqëria projektuese "Dekliada ó alb" sh.p.k, citohet se:

*"Për Hec Madhesh prurja ekologjike për veprën e marrjes nr. 1 është 0.023 m³/sek ndërsa për veprën e marrjes nr. 2, është 0.003 m³/sek. **Ujë që do të lihet për vaditje nuk ka, sepse nuk ka kërkesa për vaditje në këtë zonë.** Prurja llogaritëse për veprën e marrjes nr. 1 është 0.11 m³/s ndërsa për veprën e marrjes nr 2 është 0.99 m³/s".*

Pra, llogaritjet energjetike të Hec-it janë llogaritur të plota me prurjen, duke mos lejuar hapësirë nga burimi, për vaditje. Rrjedhimisht, i gjithë projekti, vlerësimi i ndikimit në mjedis, miratimet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), miratimet dhe oponenta nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Lejet e përdorimit të ujit nga Baseni Ujor dhe Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, **duhet të rishikohen dhe të ristudiohen llogaritjet Hidrologjike dhe vetë projekti i zbatimit.**

Pra, nuk është respektuar neni 6 pika 1/a i ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" ku përcaktohet:

"Respektimi i integritetit të baseneve ujore, bazuar në kërkesat sociale dhe ekonomike për burime ujore, duke mbrojtur dhe ruajtur cilësinë e këtyre burimeve dhe cilësinë e mjedisit për brezat e ardhshëm".

3. Në lidhje për konsultimin me publikun, duke iu referuar publikimeve zyrtare në AKM (Agjencinë Kombëtare të Mjedisit), konstatohet se, në zbatim të VKM nr. 247 datë. 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informim dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore", kreu 1 pika 1, ku shprehet:

1. *Procesi i informimit dhe i përfshirjes së publikut gjatë procedurës paraprake të VNM-së përfshin këto faza:*

a) *Informimin dhe marrjen e mendimit të publikut nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) për projektin, shoqëruar me sqarimet për procedurën në zbatim;*

b) *Shpalljen dhe publikimin e vendimit të AKM-së në faqen e saj të internetit.*

Nga verifikimet në faqen e web-it të AKM, nuk rezultoi të ketë asnjë publikim për dëgjuesën publike në Hec Madhesh dhe Hec Traja1.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport i Auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

- Gjithashtu, veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" neni 17 "Seanca dëgjimore gjatë VNM-së", ku citohet se:

1. *AKM-ja, gjatë procedurës së VNM-së së thelluar, zhvillon seancë dëgjimore me publikun dhe OJF-të e interesuara, duke synuar tërheqjen e mendimit të tyre në vendimmarrjen përfundimtare për projektin.*

2. *Seanca dëgjimore zhvillohet në bashkëpunim edhe me njësinë e qeverisjes vendore dhe me zhvilluesin e projektit.*

3. *Menjëherë pas përcaktimit të vendit, datës dhe orës për zhvillimin e seancës dëgjimore, njësia e qeverisjes vendore bën njoftimin drejtuar publikut dhe OJF-ve të interesuara për të marrë pjesë në takim.*

4. *Mendimi dhe komentet e publikut e të OJF-ve, të pranishëm në takim, janë kriter i domosdoshëm, gjatë procesit të vendimmarrjes së VNM-së.*

5. *Rregullat, kërkesat dhe procedurat për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.*

Ngjarjet e mësipërme përfshihen në rastet kur pezullohet/anulohet leja e përdorimit të ujit si më poshtë:

a. Rastet kur pezullohet leja, në bazë të nenit 50 të ligjit nr.111/2012 i ndryshuar, autorizimet, lejet dhe koncesionet për përdorimin e ujërave: í . ç) *mund të ndryshohen, të refuzohen, të pezullohen ose të shfuqizohen në bazë të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.*

Mbështetur në neni 54, të ligjit:

1. *Autorizimi, leja dhe koncesioni mund të pezullohen ose të ndryshohen kur titullari përkatës nuk përmbush kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të.*

2. *Pezullimi dhe ndryshimi i kushteve që përmbahen në licencat, autorizimet, lejet dhe koncesionet kryhen nga organi lëshues:*

a) *si pasojë e një urdhri për thatësirën, të lëshuar në bazë të këtij ligji;*

b) *kur kanë ndodhur ndryshime për shkak të forcave madhore;*

c) *me kërkesë të mbajtësit të titullit;*

ç) *në rast të mosrespektimit nga titullari të kushteve të autorizimit, lejes ose koncesionit.*

b. Rastet kur anulohet leja. Mbështetur në **nenin 55** të ligjit:

1. *Zgjidhja e kontratës koncesionare dhe shfuqizimi ose anulimi i autorizimeve dhe lejeve mund të bëhen në rastet kur:*

a) **bazuar në interesin publik dhe në përputhje me planin e menaxhimit të baseneve ujore, është i domosdoshëm përdorimi i ujërave për një qëllim tjetër parësor, në përputhje me kategorizimet, sipas përparësive të përcaktuara në nenin 52 të këtij ligji;**

b) **titullari i autorizimit, lejes, koncesionit nuk respekton kushtet përkatëse edhe pas pezullimit të lejes, autorizimit për një afat të caktuar;**

c) *me kërkesën e titullarit të autorizimit, lejes, koncesionit;*

ç) **ujërat, me të cilat lidhet leja, autorizimi ose koncesioni, nuk janë përdorur për një periudhë prej tre vjetësh;**

d) *me vdekjen e titullarit apo me mbarimin e personit juridik.*

e) *është e parashikuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport i Auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

2. Kundër vendimeve të organeve të menaxhimit të burimeve ujore për shfuqizimin ose anulimin e autorizimit/lejes bëhet ankim në gjykatën kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Për ankimet ndaj procedurave të dhënies së koncesionit dhe zgjidhjes së kontratës së koncesionit do të zbatohet legjislacioni në fuqi për koncesionet.

Referuar ngjarjeve dhe rrethanave të mësipërme, MIE duhet të marrë masa që të veprohet në mbështetje të nenit 80 të ligjit "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore":

1. Këshilli i Basenit Ujor ka të drejtë të vendosë në lidhje me pezullimin e përkohshëm, të përhershëm ose ndryshimin e lejes dhe autorizimit, kur është në kompetencën e këtij organi, nëse rrethanat, në të cilat është bazuar dhënia e tyre, kanë ndryshuar ose kur krijohen rrethana të reja, të cilat, nëse do të kishin ekzistuar në kohën e dhënies, do të kishin çuar në refuzim të lejes ose lëshimin e lejes me kushte dhe afate të tjera.

2. Këshilli i Basenit Ujor, për rastet kur kompetencën për pezullimin e përkohshëm, të përhershëm ose ndryshimin e lejes dhe autorizimit e ka Këshilli Kombëtar i Ujit, bën propozimet përkatëse me vendim formal, i cili i dërgohet Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore për t'u shqyrtuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit.

Referuar VKM-së nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" **nenit 25/6**, shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi që miratohen nga KKT-ja të përcaktohet:

Në rast se gjatë periudhës së shqyrtimit teknik, si rezultat i proceseve të bashkërendimit dhe verifikimit, **vërehen kundërshti apo mangësi**, autoriteti përgjegjës përkatës njofton, kur është rasti, kërkuar për plotësim dokumentacioni apo rishikim të projektit.

Neni **25/4** citon se, Ministria përgjegjëse e linjës dhe institucionet përkatëse të varësisë shqyrtojnë përputhshmërinë me politikat, strategjitë e legjislacionin sektorial dhe kriteret teknike të veçanta për objektin përkatës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, në subjektin e audituar, janë paraqitur shpjegime dhe komente më datë 06.05.2021 për Projekt Raportin e Auditimit, e protokolluar në KLSH me numër prot., 1146/8, datë 10.05.2021 òShkresë përcjellëse, nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, nga Drejtori i Përgjithshëm, znj. G. L., ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Sipas shkresës në fjalë nga është theksuar fakti se: bien dakord me gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH dhe në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të trajtuara në Projekt Raport, theksohet fakti se do të bashkëpunojnë me NJQV dhe çdo institucion tjetër të përfshirë në proces, mbështetur në problematikat konkrete të banorëve të zonës përkatëse si dhe do të rishikohen komponentët e lejes së HEC Madhesh, për rishikimin e parametrave hidrologjik dhe kushtet e lejes.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, rezultojnë se konstatimet e grupit të auditimit janë në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

Titulli i gjetjes
nr. 1

Mungesa e Kontrolleve të Brendshme nga MIE, në lidhje me saktësimet e përcaktimit të nevojave për përdorimin e ujit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport i Auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se, Baseni Ujor Mat ka miratuar leje të përdorimit të ujit me nr. serie 000029, të datës 22.09.2017, të miratuar me Vendimin e KBU nr. 31, datë 22.09.2017 dhe Leje për përdorimin e burimit, miratuar me Vendimin e KBU, Mat Nr. 132 datë 22.09.2017. Nga miratimi i lejes së përdorimit të ujit, është vendosur kufizimi në ushtrimin e veprimtarisë duke përcaktuar domosdoshmërisht nevojën që <u>të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezervat e domosdoshme ekologjike.</u></p> <p>Nga auditimi rezultoi se Projekti i Hartuar për HEC Madhesh dhe Hec Traja nuk kanë parashikuar vaditje për zonën, por vetëm prurje ekologjike. Referuar dokumentacionit të administruar në MIE mbi VNM e vitit 2020, hartuar nga shoqëria projektuese "D. ó alb" sh.p.k, citohet se: "Për Hec Madhesh, prurja ekologjike për veprën e marrjes nr. 1 është 0.023 m³/sek, ndërsa për veprën e marrjes nr. 2 është 0.003 m³/sek. Ujë që do të lihet për vaditje nuk ka, sepse nuk ka kërkesa për vaditje në ketë zonë. Prurja llogaritëse për veprën e marrjes nr. 1 është 0.11 m³/s ndërsa për veprën e marrjes nr. 2 është 0.99 m³/s."</p> <p>Nga verifikimi i projektit rezultoi se, llogaritjet energjetike të Hec-it janë llogaritur të plota me prurjen, duke mos lejuar hapësirë nga burimi për vaditje.</p> <p>Konstatohet se, institucionet përgjegjëse deklarojnë se nuk ka pasur kërkesa për vaditje, ndërkohë me shkresën drejtuar Njësisë Administrative Ulëz nr. 31/1 prot., datë 01.02.2017, paraqiten nevojat për vaditje, dhe me shkresën nr. 481/1 prot., datë 09.07.2020 është njoftuar edhe prefektura e Qarkut Lezhë.</p> <p>Sa më sipër, sipas Ligji Nr. 111/2012 òPër Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujoreò parashikohet një hapësirë ku Këshilli i Basenit Ujor pezullon përkohësisht ose ndryshon lejen ose autorizimin, nëse rrethanat, në të cilat është bazuar dhënia e tyre, kanë ndryshuar, ose kur krijohen rrethana të reja, të cilat nëse do të kishin ekzistuar në kohën e dhënies së lejes do të kishin çuar në lëshimin e lejes me kushte të tjera. Thënë kështu, edhe n.q.s. nuk ka patur kërkesa për vaditje përpara se të jepej leja e përdorimit të ujit (siç pretendohet nga Baseni Ujor Mat), kërkesat e kryera në vijimësi nga banorët e zonës janë të mjaftueshme për të plotësuar kushtet për rishikimin e lejes.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 111/2012 òPër Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujoreò, neni 6 pika a, neni 50, neni 55, neni 80.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e parashikimit të një sasie prurjeje për vaditje për banorët e zonës
Shkaku:	Kërkesa të vazhdueshme për vaditje nga banorët
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	1.1 Me qëllim forcimin e kontroleve të brendshme, në funksion të efikasitetit dhe ligjshmërisë së procesit: - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të ngrejë një grup pune të veçantë,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport i Auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

për të verifikuar çështjet e trajtuara, me qëllim rishikimin e kontratës koncesionare, duke qenë se nevojat e vazhdueshme për vaditje të banorëve nuk janë marrë në konsideratë dhe si pasojë nuk janë llogaritur dhe vlerësuar në projektin e zbatimit të HECE-ve.

- Grupi i punës të bashkëpunojë me Institucionet e tjera përgjegjëse të përfshira në këtë projekt, me qëllim analizimin dhe vlerësimin e të gjithë elementet të projektit, si: Vlerësimin të Ndikimit në Mjedis, Oponencën teknike dhe Lejet e Përdorimit të Ujit, në mënyrë që të rishikohen dhe ri studiohen llogaritjet hidrologjike, për nevojat dhe sasinë e ujit për vaditje

1.2 Agjencia së Menaxhimit të Burimeve Ujore, me qëllim verifikimin e ligjshmërisë së procesit për çështjen në fjalë si dhe për marrjen e masave që për çdo rast në vijim, përpara dhënies të lejeve të përdorimit të ujit, të verifikojë të gjitha kërkesat dhe nevojat e burimit ujor, me qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë së prioritetëve mbi përdorimin ujor. Në fund të këtij verifikimi, të bëhet me dije KLSH, mbi rezultatet e punës.

Titulli i gjetjes nr. 2	Mungesa e Kontrolleve të Brendshme nga MIE mbi verifikimin e përputhshmërisë ligjore të procesit të dëgjësës publike
Situata:	<p>Referuar publikimeve zyrtare në AKM (Agjencinë Kombëtare të Mjedisit), konstatohet se nga verifikimi në faqen zyrtare të AKM në Prill 2020, nuk rezulton të ketë asnjë publikim për dëgjësën publike në HEC Madhesh dhe HEC Traja 1, në kundërshtim me VKM nr. 247 datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informim dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore", kreu 1 pika 1, ku shprehet:</p> <p>1. <i>Procesi i informimit dhe i përfshirjes së publikut gjatë procedurës paraprake të VNM-së përfshin këto faza:</i></p> <p>a) <i>Informimin dhe marrjen e mendimit të publikut nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) për projektin, shoqëruar me sqarimet për procedurën në zbatim;</i></p> <p>b) <i>Shpalljen dhe publikimin e vendimit të AKM-së në faqen e saj të internetit.</i></p> <p>Gjithashtu, veprimet bien në kundërshtim me ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" neni 17 "Seanca dëgjimore gjatë VNM-së". Procesi i informimit dhe i përfshirjes së publikut gjatë procedurës paraprake të VNM-së përfshin informimin dhe marrjen e mendimit të publikut nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) për projektin, shoqëruar me sqarimet për procedurën në zbatim, si dhe shpalljen dhe publikimin e vendimit të AKM-së në faqen e saj të internetit.</p> <p>Publikimi në faqen zyrtare të AKM, sipas parashikimit në VKM, është një hap me rëndësi për të garantuar transparencë në proces. Në kushtet kur ka një pretendim të ngritur nga banorët mbi këtë përdorimin e ujit për vaditje,</p>



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport i Auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Kriteri:	dëgjesa publike duhet të ishin përditësuar në zbatim të legjislacionit në fuqi. Ligji nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", neni 17; VKM nr. 247 datë. 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informim dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore"
Ndikimi/Efekti:	Procesi i dëgjësës publike nuk është transparent.
Shkaku:	Konsultimi me publikun nuk është bërë sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim forcimin e kontrolleve të brendshme, për të garantuar një proces sa më transparent, në çdo rast të marrë masa që të verifikojë kryerjen e dëgjësave publike, sipas kuadrit ligjor në fuqi. - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet strukturave përkatëse, të ushtrorë kontrollin e nevojshëm mbi ligjshmërinë e kryerjes së procedurave të dëgjësës publike nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për rastin në fjalë, dhe në përfundim të këtij kontrolli, të bëhet me dije Kontrolli i Lartë i Shtetit mbi rezultatet e punës së kryer. - Agjencia Kombëtare e Mjedisit me qëllim marrjen e masave që për çdo rast në vijim, të kryejë dëgjësën publike, sipas parashikimeve në VKM nr. 247 datë. 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informim dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore", si një kusht i rëndësishëm për garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi përputhshmërinë¹

Për drejtimin e Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Tiranë.

Ne kemi audituar përputhshmërinë¹ e subjektit përsa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve, termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në kryerjen e procedurave të koncensionit.

Auditimi ka përfshirë zbatimin e procedurave ligjore, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në lidhje me ligjshmërinë e procedurave të ndjekura, për HEC Traja 1, në përroin e zallit dhe HEC Madhesh në lumin e Lunresë, degë e lumit Mat, Bashkia Mat, Qarku Dibër, nëpërmjet veprimeve të kryera nga Baseni Ujor Mat, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, MIE si dhe projekti i veprës.

Opinion i kundërt²:

¹ Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së".



Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e 6Bazës për opinionin e kundërt, procedurat e dhënies me koncension për HEC Traja 1 dhe HEC Madhesh u konstatuan pasaktësi mbi përdorimin e ujit dhe dëgjësive publike të banorëve të zonës. Në vlerësimin e Ndikimit në Mjedis u konstatua pasaktësi në kundërshtim me legjislacionin mjedisor në fuqi.

Baza për opinionin e kundërt:

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se: Nga auditimi i dosjes fizike në MIE, rezultoi se, Baseni Ujor Mat ka miratuar: (i) lejen e përdorimit të ujit me nr. serie 000029, të datës 22.09.2017, të miratuar me Vendimin e KBU nr. 31, datë 22.09.2017; dhe (ii) lejen për përdorimin e burimit, miratuar me Vendimin e KBU Mat, Nr. 132 datë 22.09.2017. Nga miratimi i lejes së përdorimit të ujit, është vendosur kufizimi në ushtrimin e veprimtarisë duke përcaktuar që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezervat e domosdoshme ekologjike. Në vijim të sa mësipër, nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se projekti i hartuar për HEC Madhesh dhe Hec Traja nuk kanë parashikuar vaditje për zonën, por vetëm prurje ekologjike. Referuar dokumentacionit të administruar në MIE mbi VNM-në e vitit 2020, hartuar nga shoqëria projektuese "Dekliada ó alb" sh.p.k, citohet se "Për Hec Madhesh, prurja ekologjike për veprën e marrjes nr. 1 është 0.023 m³/sek, ndërsa për veprën e marrjes nr. 2 është 0.003 m³/sek. *Ujë që do të lihet për vaditje nuk ka, sepse nuk ka kërkesa për vaditje në këtë zonë.* Prurja llogaritëse për veprën e marrjes nr. 1 është 0.11 m³/s ndërsa për veprën e marrjes nr 2 është 0.99 m³/s. Nga verifikimi i projektit rezultoi se, llogaritjet energjetike të Hec-it janë llogaritur të plota me Prurjen, duke mos lejuar hapësirë nga burimi për vaditje. Konstatohet se, Institucionet përgjegjëse deklarojnë se nuk ka pasur kërkesa për vaditje, ndërkohë me shkresën drejtuar Njësisë Administrative Ulëz nr. 31/1 prot., datë 01.02.2017, paraqiten nevojat për vaditje dhe me shkresën nr. 481/1 prot., datë 09.07.2020, është njoftuar edhe prefektura e Qarkut Lezhë. Sa më sipër, sipas Ligji Nr. 111/2012 *oPër Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore* parashikohet një hapësirë ku Këshilli i Basenit Ujor pezullon përkohësisht ose ndryshon lejen ose autorizimin, nëse rrethanat, në të cilat është bazuar dhënia e tyre, kanë ndryshuar, ose kur krijohen rrethana të reja, të cilat nëse do të kishin ekzistuar në kohën e dhënies së lejes do të kishin çuar në lëshimin e lejes me kushte të tjera. Thënë kështu, edhe nëse nuk ka patur kërkesa për vaditje përpara se të jepej leja e përdorimit të ujit, siç pretendohet nga Baseni Ujor Mat, kërkesat e kryera në vijimësi nga banorët e zonës janë të mjaftueshme për të rishikuar kushtet e lejes.

Referuar publikimeve zyrtare në AKM (Agjencinë Kombëtare të Mjedisit), konstatohet se nga verifikimi në faqen zyrtare të AKM në Prill 2020, nuk rezulton të ketë asnjë publikim për dëgjësën publike në HEC Madhesh dhe HEC Traja1, në kundërshtim me VKM nr. 247 datë. 30.04.2014 "*Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informim dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore*", kreu 1 pika 1, ku shprehet:

1. *Procesi i informimit dhe i përfshirjes së publikut gjatë procedurës paraprake të VNM-së*

² **Opinionin e kundërt.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërrputshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, të përhapura, në transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale të përhapura.



përfshin këto faza: a) Informimin dhe marrjen e mendimit të publikut nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) për projektin, shoqëruar me sqarimet për procedurën në zbatim; b) Shpalljen dhe publikimin e vendimit të AKM-së në faqen e saj të internetit. Veprimet gjithashtu bien në kundërshtim me ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" neni 17 "Seanca dëgjimore gjatë VNM-së". Procesi i informimit dhe i përfshirjes së publikut gjatë procedurës paraprake të Vendimit mbi Ndikimin Mjedisor (VNM) përfshin informimin dhe marrjen e mendimit të publikut nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) për projektin, shoqëruar me sqarimet për procedurën në zbatim, si dhe shpalljen dhe publikimin e vendimit të AKM-së në faqen e saj të internetit, si një hap me rëndësi për të garantuar transparencë në proces. Në kushtet kur ka një pretendim të ngritur nga banorët në lidhje me cenimin e këtij procesi, vlerësojmë që dëgjesa publike duhet të ishin përditësuar dhe publikuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përgjegjësitë e Drejtuesve: Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Strukturat drejtuese, referuar ngjarjeve dhe rrethanave të mësipërme, Drejtoria e PPP duhet të kishte marrë masa që të veprohej në rastet kur pezullohet/anullohet leja e përdorimit të ujit në bazë të nenit 50, 54, 55 të ligjit nr.111/2012 i ndryshuar,

Referuar ngjarjeve dhe rrethanave të mësipërme, MIE duhet të kishte marrë masa që të veprohet në mbështetje të nenit 80 të ligjit "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", pika dhe pika 2 si dhe VKM-së nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" **nenit 25/4 dhe /6**, shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi që miratohen nga KKT-ja.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse procedurat koncensionit të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor MIE, Tiranë, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse procedurat e koncensionit janë zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes fizike në MIE, rezultoi se, Baseni Ujor Mat ka miratuar: (i) lejen e përdorimit të ujit me nr. serie 000029, të datës 22.09.2017, të miratuar me Vendimin e KBU nr. 31, datë 22.09.2017; dhe (ii) lejen për përdorimin e burimit, miratuar me Vendimin e KBU Mat, Nr. 132 datë 22.09.2017. Nga miratimi i lejes së përdorimit të ujit, është vendosur kufizimi në ushtrimin e veprimtarisë duke përcaktuar që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezervat e domosdoshme ekologjike. Në vijim të sa mësipër, nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se projekti i hartuar për HEC Madhesh dhe Hec Traja nuk kanë parashikuar vadtje për zonën, por vetëm prurje ekologjike. Referuar dokumentacionit të administruar në MIE mbi VNM-në e vitit 2020, hartuar nga shoqëria projektuese "D.ó alb" sh.p.k, citohet se "Për Hec Madhesh, prurja ekologjike për veprën e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport i Auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

marrjes nr. 1 është 0.023 m³/sek, ndërsa për veprën e marrjes nr. 2 është 0.003 m³/sek. *Ujë që do të lihet për vaditje nuk ka, sepse nuk ka kërkesa për vaditje në këtë zonë.* Prurja llogaritëse për veprën e marrjes nr. 1 është 0.11 m³/s ndërsa për veprën e marrjes nr 2 është 0.99 m³/s. Nga verifikimi i projektit rezultoi se, llogaritjet energjetike të Hec-it janë llogaritur të plota me Prurjen, duke mos lejuar hapësirë nga burimi për vaditje. Konstatohet se, Institucionet përgjegjëse deklarojnë se nuk ka pasur kërkesa për vaditje, ndërkohë me shkresën drejtuar Njësisë Administrative Ulëz nr. 31/1 prot., datë 01.02.2017, paraqiten nevojat për vaditje dhe me shkresën nr. 481/1 prot., datë 09.07.2020, është njoftuar edhe prefektura e Qarkut Lezhë.

Sa më sipër, sipas Ligji Nr. 111/2012 òPër Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujoreò parashikohet një hapësirë ku Këshilli i Basenit Ujor pezullon përkohësisht ose ndryshon lejen ose autorizimin, nëse rrethanat, në të cilat është bazuar dhënia e tyre, kanë ndryshuar, ose kur krijohen rrethana të reja, të cilat nëse do të kishin ekzistuar në kohën e dhënies së lejes do të kishin çuar në lëshimin e lejes me kushte të tjera. Thënë kështu, edhe nëse nuk ka patur kërkesa për vaditje përpara se të jepej leja e përdorimit të ujit, siç pretendohet nga Baseni Ujor Mat, kërkesat e kryera në vijimësi nga banorët e zonës janë të mjaftueshme për të rishikuar kushtet e lejes.

(Më hollësisht trajtuar faqe 9 -20 Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Me qëllim forcimin e kontrolleve të brendshme, në funksion të efikasitetit dhe ligjshmërisë së procesit si dhe në mbështetje të kuadrit ligjor e rregullator në fuqi për menaxhimin e integruar të Burimeve Ujore:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të ngrejë një grup pune të veçantë, për të verifikuar çështjet e trajtuara, me qëllim rishikimin e kontratës koncesionare, duke qenë se nevojat e vazhdueshme për vaditje të banorëve nuk janë marrë në konsideratë dhe si pasojë nuk janë llogaritur dhe vlerësuar në projektin e zbatimit të HECE-ve.

- Grupi i punës të bashkëpunojë me Institucionet e tjera përgjegjëse të përfshira në këtë projekt, me qëllim analizimin dhe vlerësimin e të gjithë elementet të projektit, si: Vlerësimin të Ndikimit në Mjedis, Oponencën teknike dhe Lejet e Përdorimit të Ujit, në mënyrë që të rishikohen dhe ri studiohen llogaritjet hidrologjike, për nevojat dhe sasinë e ujit për vaditje

Menjëherë

1.2 Rekomandimi: Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, me qëllim verifikimin e ligjshmërisë së procesit për çështjen në fjalë si dhe për marrjen e masave që për çdo rast në vijim, përpara dhënies së lejeve të përdorimit të ujit, të verifikojë të gjitha kërkesat dhe nevojat e burimit ujor, me qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë së prioritetëve mbi përdorimin ujor. Në fund të këtij verifikimi, të bëhet me dije KLSH, mbi rezultatet e punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Referuar publikimeve zyrtare në AKM (Agjencinë Kombëtare të Mjedisit), konstatohet se nga verifikimi në faqen zyrtare të AKM në Prill 2020, nuk rezulton të ketë asnjë publikim për dëgjuesën publike në HEC Madhesh dhe HEC Traja1, në kundërshtim me VKM nr. 247 datë. 30.04.2014 "*Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informim dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore*", kreu 1 pika 1, ku shprehet:

1. *Procesi i informimit dhe i përfshirjes së publikut gjatë procedurës paraprake të VNM-së përfshin këto faza:a) Informimin dhe marrjen e mendimit të publikut nga Agjencia Kombëtare e*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport i Auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Mjedisit (AKM) për projektin, shoqëruar me sqarimet për procedurën në zbatim; b) Shpalljen dhe publikimin e vendimit të AKM-së në faqen e saj të internetit. Veprimet gjithashtu bien në kundërshtim me ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" neni 17 "Seanca dëgjimore gjatë VNM-së". Procesi i informimit dhe i përfshirjes së publikut gjatë procedurës paraprake të Vendimit mbi Ndikimin Mjedisor (VNM) përfshin informimin dhe marrjen e mendimit të publikut nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) për projektin, shoqëruar me sqarimet për procedurën në zbatim, si dhe shpalljen dhe publikimin e vendimit të AKM-së në faqen e saj të internetit, si një hap me rëndësi për të garantuar transparencë në proces. Në kushtet kur ka një pretendim të ngritur nga banorët në lidhje me cenimin e këtij procesi, vlerësojmë që dëgjesa publike duhet të ishin përditësuar dhe publikuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

(Më hollësisht trajtuar faqe 9 -20 Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim forcimin e kontroleve të brendshme, për të garantuar një proces sa më transparent, në çdo rast të marrë masa që të verifikojë kryerjen e dëgjësive publike, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

2.2 Rekomandimi: Ministria e Turizimit dhe Mjedisit, nëpërmjet strukturave përkatëse, të ushtrojë kontrollin e nevojshëm mbi ligjshmërinë e kryerjes së procedurave të dëgjësive publike nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për rastin në fjalë, dhe në përfundim të këtij kontrolli, të bëhet me dije Kontrolli i Lartë i Shtetit mbi rezultatet e punës së kryer.

- Agjencia Kombëtare të Mjedisit me qëllim marrjen e masave që për cdo rast në vijim, të kryejë dëgjësën publike, sipas parashikimeve në VKM nr. 247 datë. 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informim dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore", si një kusht i rëndësishëm për garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, gjerat (b, c, ç) e nenin 58 - ÷Llojet e masave disiplinore, të ligjit nr. 152/2013 për nëpunësin civil, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, i rekomandojmë Ministrin të Infrastrukturës dhe Energjisë të analizojë dhe të vlerësojë të metat, mangësitë dhe përgjegjësitë individuale të punonjësve të MIE, trajtuar në Raportin Përfundimtar Tematik të KLSH-së, me qëllim nisjen e procedurave të nevojshme administrative për dhënien e masave disiplinore përkatëse, për mosveprimet e mëposhtme:

Banorët e fshatit Madhesh, u janë drejtuar MIE në rrugë zyrtare, për kërkesat e vazhdueshme për vaditje me nr. 1030 dëftesë 23.12.2020.

Projekti i Hartuar për HEC Madhesh dhe Hec Traja nuk ka parashikuar vaditje për zonën, por vetëm prurje ekologjike. Referuar dokumentacionit të administruar në MIE mbi VNM e vitit 2020 hartuar nga shoqëria projektuese, citohet se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport i Auditimit tematik të ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

"Për Hec Madhesh prurja ekologjike për veprën e marrjes nr. 1 është 0.023 m³/sek ndërsa për veprën e marrjes nr. 2 është 0.003 m³/sek. **Ujë që do të lihet për vaditje nuk ka, sepse nuk ka kërkesa për vaditje në këtë zonë.** Prurja llogaritëse për veprën e marrjes nr. 1 është 0.11 m³/s ndërsa për veprën e marrjes nr. 2 është 0.99 m³/s".

Referuar ngjarjeve dhe rrethanave të mësipërme, Drejtoria e PPP duhet të kishte marrë masa që të veprohej në rastet kur pezullohet/anulohet leja e përdorimit të ujit në bazë të nenit 50, 54, 55 të ligjit nr.111/2012 i ndryshuar,.

Referuar ngjarjeve dhe rrethanave të mësipërme, MIE duhet të kishte marrë masa që të veprohet në mbështetje të nenit 80 të ligjit "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", pika dhe pika 2 si dhe VKM-së nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" **nenit 25/4 dhe /6**, shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi që miratohen nga KKT-ja.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT